FEDERATA E GJIMNASTIKËS E KOSOVËS
KOSOVA GYMNASTIC FEDERATION

PROCES VERBALI I KUVENDIT TË JASHTËZAKONSHËM

Bordi i FGJK duke u bazuar në statutin e FGJK-së, Neni 20, paragrapfi 1, ka njoftuar dhe thirrur Kuvend të Jashtëzakonshëm, i cili do të mbahet e datë 09-03-2025, në hapësirat e Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit në Prishtinë, për arsye të Harmonizimit të Statutit të FGJK-së, me Ligjin për Sport, dhe Harmonizimin e Rregulloreve të Punës së Kuvendit dhe Bordit. Njoftimi kuvendarëve i është bërë nëpërmjet email adresave dhe ne grup të rrjetit social facebook mesengjer me datë 27 Shkurt 2025, dhe materiali i është dërguar me datë 03-03-2025.

Të ftuar janë të gjithë anëtarët e Kuvendit të FGJK, në total 15 klube të licensuara.

Në bazë të nenit 17 numri dhe përcaktimi i delegatëve, numri i delegatëve përcaktohet si më poshtë:

a. Çdo shoqatë apo klub sportiv ka 3 (tre) delegat.

b. Çdo delegat ka të drejtën e 1 (një) vote.

REND I DITËS

1. **Hapja e mbledhjes nga Kryetari**: – Kryetari i FGJK-së, Z. Shkumbin Maqastena, falenderoj të pranishmit për pjesëmarrje në këtë kuvend të jashtëzakonshëm, për harmonizim të statutit dhe rregulloreve të FGJK-së.
2. **Caktimi i një proces-mbajtësi**: – Kryetari i FGJK-së, Z. Shkumbin Maqastena propozoj që proces mbajtës për këtë kuvend të jetë Z. Elfete Gashi, ku te gjithe të pranishmit ishin për, nuk kishtë kundër apo abstenim.
3. **Caktimi i tre anëtarëve për Komision Verifikues të Kuvendit:** - pjesëmarrsëve në mbledhje, numri i tyre, - Kryetari i FGJK-së, Z. Shkumbin Maqastena, propozoj që tre anëtarët e komisionit për verifikim të jenë:
   - Ard Kryeziu,
   - Doruntinë Ibrahimi,
   - Arlind Shaqiri, ku pas propozimit, Kryetari kërkoj nga të pranishmit të votohet, ku të gjithë të pranishmit unanimisht votuan për, nuk kishte kundër apo abstenime.
   - Komisioni i vertifikimit, vërtetoj se në kuvend të pranishëm janë 25 anëtar me të drejtë vote, nga 45 sa janë të licencuar në 15 klube gjimnastikore, dhe vërtetohet se ka korum për mbajtjen e kuvendit të jashtëzakonshëm.

FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com

4. **Miratimi i ndryshimeve të Statutit të FGJK-së**: - Sekretari i Përgjithshëm i FGJK-së, Z. Amir Tahiraga, prezontoj Preambulën, Statutin dhe nenet të cilat janë shtuar dhe rregulluar duke bërë harmonizimin me ligjin për sport Nr. 08/L-277, gjithashtu duke cekur se i njejti material i është dërgu me kohë të gjithë anëtarëve të kuvendit, dhe se deri me sot nuk kemi pranuar komente.
   - Pas shqyrtimit të statutit të gjithë anëtarët e Kuvendit të FGJK-së, unanimisht votuan për ndryshime dhe harmonizim të statutit të FGJK-së, nuk kishte kundër apo abstenim.
5. **Miratimi i ndryshimeve të Rregulloreve të FGJK-së, gjegjësisht:** -
   a. Rregulloren e punës së Kuvendit të FGJK-së,
   b. Rregulloren e punës së Bordit Ekzekutiv të FGJK-së. Sekretari i Përgjithshëm i FGJK-së, Z. Amir Tahiraga, i njoftoj të pranishmit që janë bërë disa ndryshime kryesisht në rangimin e neneve si në rregullorën e punës së kuvendit të FGJK-së, ashtu edhe në rregulloren e bordit ekzekutiv të FGJK-së, materiali është dërguar me kohë, dhe deri me sot nuk kemi pranuar asnjë koment, andaj kërkojmë nga Kuvendorat që të votohet Rregullorja e Punës së Kuvendit të FGJK-së, dhe të gjithë të pranishmit votuan për, nuk kishte kundër apo abstenim, pas miratimit të rregullores, kuvendarët e FGJK-së, votuan unanimisht edhe për rregulloren e Bordit Ekzekutiv të FGJK-së.
6. **Kërkesë për delegimin e përkohshëm të kompetencave për ndryshime statutore dhënë Kryetarit – Sekrektarit të Përgjithshëm, Teknik, dhe Bordit të FGJK-së:** - Sekretari i Përgjithshëm i FGJK-së, Z. Amir Tahiraga, njoftoj të pranishmit se, ndryshimet në statut janë bërë, dhe se statuti me ndryshime do të dërgohet te komisioni për vlerësim dhe licensim të federatave sportive, dhe po që se kanë ndonjë vërejtje, ose kërkohet që të bëhet ndryshim apo përmirësim, ne kërkojmë nga Kuvendarët që këtë punë të i'a besojnë dhe delegojnë Kryetari, Sekretari të Përgjithshëm, Teknik dhe Bordit Ekzekutiv, për miratim të ndryshimeve, kjo kërkohet për arsye që mos të thirret Kyvendi shumë shpesh. Të gjithë të pranishmit unanimisht votuan për, nuk kishte kundër apo abstenim.
7. **Të ndryshme:** - Kryetari i Klubit të Gjimnastikës "LIPAJNI", Z. Aziz Rama, kërkoj nga Federata e Gjimnastikës e Kosovës që të gjejnë një student, asistente e cila do kisht mundur të ndihmoj klubin duke ngrit cilësin e gjimnastikës. Salla të cilin klubi do vazhdoj stërvitjet është e pajisur me vegla. Pas kërkesës së bërë, Kryetari Z. Maqastena u shpreh se do shikohet të bëhet një zgjidhje për ju sepse një kërkesë të tillë e ka pasur edhe klubi i gjimnastikës "Trepça", dhe se jemi duke punuar në atë drejtim, së bashku

FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com

me Nënkryetarin e FGJK-së Z. Besim Halilaj, dhe të tjetër për të identifikuar student/e të cilat kanë njohur në gjimnastikë dhe që janë nga Lipjani apo Mitrovica, që mos të kenë problem udhëtimin.

7.1. Sekretari i FGJK-së, njoftojë të pranishmit se kërkesa e bërë nga FGJK tek KOK për mbështetje financiare për Gjimnasten Jara Hasolli, e cila vuan nga smundja e diabetit 1, është aprovuar dhe se Jara do të përfitoj një shumë prej 1500 euro, bazu në vendim të lëshuar nga KOK.

7.2. Gjitashtu të pranishmit janë njoftuar që Memorandumi i Bashkëpunimit në mes të MKRS dhe FGJK është nënshkruar, dhe se jemi në pritje për shpërndarjen e tm1 në xhirollogari të FGJK-së.

Sekretar i Pëgjithshëm i FGJK-së
Amir Tahiraga

FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com